



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 par 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 13 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë si dhe nenit 20 par. 20.1 dhe 36 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës 31.01.2021, të miratojë këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Nexhmedin Lekiqi, anëtar subjekti politik LDK
2. Gazmend Qerkini, anëtar subjekti politik LDK
3. Shefki Bytyqi, anëtar subjekti politik LDK
4. Ganimete Qeriqi, anëtare subjekti politik PDK
5. Fitim Mëziu, anëtar subjekti politik LVV

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- 1.Bën monitorimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në komunë ,

2.Bën monitorimin e zbatimit të dispozitave në lidhje me familjet me kushte të rënda sociale, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, fëmijët e mitur, të pastrehët , invalidët e luftës dhe pensionistët.

4.Konsultohet dhe ndihmon Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.

5.Komiteti gjatë gjithë punës së tij do ti përmahet dispozitatave të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.

6. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.

Neni 4 Mandati

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka mandat 4 vjeçar

Neni 5 Kompensimi

Anëtarët e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale kompensohen nga buxheti i komunës.

Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Anëtarët e komiteteve tjera paguhën për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 020-6056

Lipjan, më 31.01. 2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

